



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TRANSPORTIT
DHE INFRASTRUKTURES

MINISTRI

UDHËZIM

Nr. 1546, datë 29/03/2016

**AUTORIPARIMI I MJETEVE RRUGORE ME MOTOR DHE
RIMORKIOVE**

Në mbështetje të: pikës 4, neni 102, të Kushtetutës; ligjit nr. 10081, datë 23.2.2009 "Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar; ligjit nr. 9573, datë 3.7.2006 "Për autoriparimin, shitblerjen, depozitimin e mjeteve rrugore me motor, të rimorkiove dhe pjesëve të tyre të dala jashtë përdorimit ose të braktisura dhe për veprimtaritë që lidhen me to", të ndryshuar; Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 538, datë 26.05.2009 "Për licencat dhe lejet, që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta", të ndryshuar;

Për t'iu përgjigjur kërkesave në rritje të sigurisë së qarkullimit rrugor dhe vendosjes së standarteve për veprimtaritë e: autoriparimit; shitblerjes së mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove të tyre; mbledhjes, depozitimit dhe shkatërimit të mjeteve dhe pjesëve të tyre të dala jashtë përdorimit ose të braktisura; etj, Ministri i Transportit dhe Infrastrukturës

UDHËZON:

Neni 1

Subjektet juridike, për të marrë licencë për veprimtaritë "Autoriparimi i mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove", me kodin VII.3.B.1/a, b, c, ç, d, dh, në Qendrën Kombëtare të Licencimit (QKL), në juridiksionin e të cilit është selia e subjektit, dhe për të ushtruar veprimtaritë e autoriparimit, në një ose në disa nga specifikimet e përcaktuara në të, duhet të disponojnë pajisjet, instrumentat, ambientet e nevojshme, si dhe të plotësojnë kushtet dhe procedurat, respektivisht, sipas nenit ose neneve përkatëse të këtij udhëzimi.

Neni 2

VII.3.B.1/a Riparimi dhe mirëmbajtja e pjesëve mekanike dhe të motorit, të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove

1. Subjektet juridike, që të ushtrojnë veprimtarinë e riparimit dhe të mirëmbajtjes së pjesëve mekanike dhe të motorit, të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove, duhet të disponojnë:

PAJISJE DHE INSTRUMENTA

- a) Gropë riparimi 1 (një), ku mund të qëndrojë një autoveturë ose sipas rastit një kamion / autobus, ose pajisje ngritëse (hidraulike ose elektrike) 1(një) copë, sipas standarteve teknike;
- b) Elektrokompresor 1 (një) copë;
- c) Kompjuter 1 (një) copë;
- d) Pajisje të mbrojtjes nga zjarri 2 (dy) copë;
- e) Kutitë ndihmës së shpejtë 1 (një) cope;
- f) Lampa portative me transformator 220 / 24 – 36 volt 2 (dy) copë;
- g) Diagnostikues për kontrollin e parametrave të motorit 1 (një) copë;
- h) Vegla matëse dhe të kontrollit nga 1 (një) seri, për profesionin motorist, xhenerik, etj;
- i) Kazan për mbeturinat 1 (një) copë;
- j) Fuçi për grumbullimin e vajrave të përdorur 1 (një) copë.

AMBIENTE

- a) Ambient të mbyllur, me ndriçimin e duhur dhe instalimet e nevojshme elektrike dhe të ajrimit, me sipërfaqe jo me pak se 30 (tridhjetë) metra katror, ku mund të qëndrojë 1 (një) autoveturë ose sipas rastit 1 (një) kamion / autobus;
 - b) Vend qëndrimi për mjetet që do të riparohen, ku mund të qëndrojë 1 (një) autoveturë ose sipas rastit 1 (një) kamion / autobus;
 - c) Zyrë për punë administrative;
 - d) Nyje hidrosanitare;
2. Subjektet juridike, që të pajisen me licencë për ushtrimin e veprimtarisë së riparimit dhe të mirëmbajtjes së pjesëve mekanike dhe të motorit, të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove, kodi VII.3.B.1/a, duhet të plotësojnë kushtet dhe procedurat si më poshtë vijon:
 - a) Kërkesë, nga drejtuesi ligjor, për pajisjen me licencë veprimtarie për riparimin dhe mirëmbajtjen e pjesëve mekanike dhe të motorit, të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove, ku të përcaktohen, emri i

subjektit, emri i drejtuesit ligjor dhe i përgjegjësit teknik, përmban dhe vetdeklarimin, sipas formatit të hartuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit për:

- gjëndjen e tij në lidhje me organet e prokurorisë dhe të gjykatës;
 - njohjen dhe zbatimin e legjislacionin dhe të rregullave në fuqi;
 - dërgim informacioni periodik, për veprimtarinë e shoqërisë, etj;
 - informacion në lidhje me pajisjet, instrumentat dhe ambientet e nevojshme që subjekti disponon, në lidhje me fushën e veprimtarisë ku kërkohet të licencohet;
- b) Kopje të Dëshmis së aftësisë profesionale të përgjegjësit teknik;
- c) Kontratë midis drejtuesit ligjor dhe përgjegjësit teknik, e hartuar përpara noterit, me afat të përcaktuar mbi 1 (një) vit;
- d) Dokumente pronësie dhe/ose përdorimi, që pasqyrojnë mjediset, pajisjet, instrumentat, etj;
- e) Rregullore e brendshme e funksionimit të veprimtarisë, e cila duhet të përmbajë dhe:
- Zbatimin e ligjit nr 9573, datë 03.07.2006 “Për autoriparimin, shitblerjen, depozitimin e mjeteve rrugore me motor, të rimorkiove dhe pjesëve të tyre të dala jashtë përdorimit ose të braktisura dhe për veprimtaritë që lidhen me to”;
 - Zbatimin e Udhëzimit “Autoriparimi i mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove”, i ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës;
 - Plotësimin e Regjistrimit për autoriparimin e mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove, VII.3.B.1/a - Riparimi dhe mirëmbajtja e pjesëve mekanike dhe të motorit, të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove;
 - Zbatimin e rregullave të sigurimit teknik në punë;
 - Zbatimin e rregullave të mbrojtjes nga zjarri;
- f) Dokument që vërteton ngurtësimin e vleftës së garancisë financiare.

Neni 3

VII.3.B.1/b Riparimi dhe mirëmbajtja e karrocërisë, të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove

1. Subjektet juridike, që të ushtrojnë veprimtarinë e riparimit dhe të mirëmbajtjes së karrocërisë, të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove, duhet të disponojnë:

PAJISJE DHE INSTRUMENTA

- a) Grupë riparimi 1 (një) copë, ku mund të qëndrojnë një autoveturë ose sipas rastit një kamion / autobus, ose pajisje ngritëse (hidraulike ose elektrike), 1 (një) copë, sipas standarteve teknike;

- b) Elektrokompresor 1 (një) copë;
- c) Kompjuter (1 (një) copë;
- d) Pajisje të mbrojtjes nga zjarri 2 (dy) copë;
- e) Kutitë të ndihmës së shpejtë 1 (një) copë;
- f) Lampa portative me transformator 220 / 24 – 36 volt 2 (dy) copë;
- g) Kazan për mbeturinat 1 (një) copë.

AMBIENTE

- a) Ambient të mbyllur, me ndriçimin e duhur dhe instalimet e nevojshme, elektrike dhe të ajrimit, me sipërfaqe jo me pak se 30 (tridhjetë) metra katror, ku mund të qëndrojnë një autoveturë ose një kamion/autobus;
 - b) Vend qëndrimi për mjetet që do të riparohen, ku mund të qëndrojnë një autoveturë ose sipas rastit një kamion / autobus;
 - c) Zyrë për punë administrative;
 - d) Nyje hidrosanitare.
2. Subjektet juridike, që të pajisen me licencë për ushtrimin e veprimtarisë së riparimit dhe të mirëmbajtjes të karrocërisë, të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove, kodi VII.3.B.1/b, duhet të plotësojnë kushtet dhe procedurat si më poshtë vijon:
- a) Kërkesë, nga drejtuesi ligjor, për pajisjen me licencë veprimtarie për riparimin dhe mirëmbajtjen e karrocërisë, të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove, ku të përcaktohen, emri i subjektit, i drejtuesit ligjor dhe i përgjegjësit teknik, përmban dhe vetdeklarimin sipas formatit të hartuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit për:
 - gjëndjen e tij në lidhje me organet e prokurorisë dhe të gjykatës;
 - njohjen dhe zbatimin e legjislacionin dhe të rregullave në fuqi;
 - dërgim informacioni periodik, për veprimtarinë e shoqërisë, etj;
 - informacion në lidhje me pajisjet, instrumentat dhe ambientet e nevojshme që subjekti disponon, në lidhje me fushën e veprimtarisë ku kërkohet të licencohet;
 - b) Kopje të Dëshmisë së aftësisë profesionale të përgjegjësit teknik;
 - c) Kontratë midis drejtuesit ligjor dhe përgjegjësit teknik, e hartuar përpara noterit, me afat të përcaktuar mbi 1 (një) vit;
 - d) Dokumente pronësie dhe/ose përdorimi, që pasqyrojnë mjediset, pajisjet, instrumentat, etj;
 - e) Rregullore e brendshme e funksionimit të veprimtarisë, e cila duhet të përmbajë dhe:

- Zbatimin e ligjit nr 9573, datë 03.07.2006 “Për autoriparimin, shitblerjen, depozitimin e mjeteve rrugore me motor, të rimorkiove dhe pjesëve të tyre të dala jashtë përdorimit ose të braktisura dhe për veprimtaritë që lidhen me to”;
 - Zbatimin e Udhëzimit “Autoriparimi i mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove”, i ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës;
 - Plotësimin e Regjistrimit për autoriparimin e mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove, VII.3.B.1/b - Riparimi dhe mirëmbajtja e karocersisë, të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove;
 - Zbatimin e rregullave të sigurimit teknik në punë;
 - Zbatimin e rregullave të mbrojtjes nga zjarri;
- f) Dokument që vërteton ngurtësimin e vleftës së garancisë financiare.

Neni 4

VII.3.B.1/c Riparimi dhe mirëmbajtja e impiantit elektrik, të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove

1. Subjektet juridike, që të ushtrojnë veprimtarinë e riparimit dhe të mirëmbajtjes së impiantit elektrik, të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove, duhet të disponojnë:

PAJISJE DHE INSTRUMENTA

- a) Pajisje ngritëse (mekanike, hidraulike ose elektrike) 1 (një) copë, sipas standarteve teknike;
- b) Pajisje për kontrollin e parametrave elektrik, të ndezjes dhe të sistemit të ushqimit 1 (një) copë;
- c) Kompjuter 1 (një) copë;
- d) Pajisje të mbrojtjes nga zjarri 2 (dy) copë;
- e) Kutitë ndihmëse të shpejtë 1 (një) copë;
- f) Lampa portative me transformator 220 / 24 – 36 volt 2 (dy) copë;
- g) Vegla matëse e të kontrollit 1 (një) seri, për profesionin elektroauto, etj.;
- h) Kazan për mbeturinat 1 (një) copë.

AMBIENTE

- a) Ambient të mbyllur, me ndriçimin e duhur dhe instalimet e nevojshme, elektrike dhe të ajrimit, me sipërfaqe jo më pak se 30 (tridhjetë) metra katror, ku mund të qëndrojë një autoveturë ose sipas rastit një kamion / autobus;
- b) Vend qëndrimi për mjetet që do të riparohen, ku mund të qëndrojë një autoveturë ose sipas rastit një kamion / autobus;

- c) Zyrë për punë administrative;
 - d) Nyje hidrosanitare.
2. Subjektet juridike, që të pajisen me licencë për ushtrimin e veprimtarisë së riparimit dhe të mirëmbajtjes së impiantit elektrik, të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove, kodi VII.3.B.1/c, duhet të plotësojnë kushtet dhe procedurat si më poshtë vijon:
- a) Kërkesë, nga drejtuesi ligjor, për pajisjen me licencë veprimtarie për riparimin dhe mirëmbajtjen e impiantit elektrik, të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove, ku të përcaktohen, emri i subjektit, i drejtuesit ligjor dhe i përgjegjësit teknik, përmban dhe vetdeklarimin sipas formatit të hartuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit për:
 - gjëndjen e tij në lidhje me organet e prokurorisë dhe të gjykatës;
 - njohjen dhe zbatimin e legjislacionin dhe të rregullave në fuqi;
 - dërgim informacioni periodik, për veprimtarinë e shoqërisë, etj;
 - informacion në lidhje me pajisjet, instrumentat dhe ambientet e nevojshme që subjekti disponon, në lidhje me fushën e veprimtarisë ku kërkohet të liçensohet;
 - b) Kopje të Dëshmisë së aftësisë profesionale të përgjegjësit teknik;
 - c) Kontratë midis drejtuesit ligjor dhe përgjegjësit teknik, e hartuar përpara noterit, me afat të përcaktuar mbi 1 (një) vit;
 - d) Dokumente pronësie dhe/ose përdorimi, që pasqyrojnë mjediset, pajisjet, instrumentat, etj;
 - e) Rregullore e brendshme e funksionimit të veprimtarisë, e cila duhet të përmbajë dhe:
 - Zbatimin e ligjit nr 9573, datë 03.07.2006 “Për autoriparimin, shitblerjen, depozitimin e mjeteve rrugore me motor, të rimorkiove dhe pjesëve të tyre të dala jashtë përdorimit ose të braktisura dhe për veprimtaritë që lidhen me to”;
 - Zbatimin e Udhëzimit “Autoriparimi i mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove”, i ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës;
 - Plotësimin e Regjistrimit për autoriparimin e mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove, VII.3.B.1/c - Riparimi dhe mirëmbajtja e impiantit elektrik, të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove;
 - Zbatimin e rregullave të sigurimit teknik në punë;
 - Zbatimin e rregullave të mbrojtjes nga zjarri;
 - f) Dokument që vërteton ngurtësimin e vleftës së garancisë financiare.

Neni 5

VII.3.B.1/ç Riparimi dhe mirëmbajtja e gomave, të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove

1. Subjektet juridike, që të ushtrojnë veprimtarinë e riparimit dhe të mirëmbajtjes së gomave, të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove, duhet të disponojnë:

PAJISJE DHE INSTRUMENTA

- a) Ngritësa (mekanik, hidraulik ose elektrik) 1 (një) copë, sipas standarteve teknike;
- b) Pajisje për kontrollin e gjeometrisë dhe të konvergjencës së gomave 1 (një) copë;
- c) Pajisje për kontrollin e presionit të fryrjes së gomave 1 (një) copë;
- d) Pajisje për zmontimin dhe montimin e gomave 1 (një) copë;
- e) Elektrokompresor 1 (një) copë;
- f) Kompjuter 1 (një) copë;
- g) Pajisje të mbrojtjes nga zjarri 1 (një) copë;
- h) Kutitë ndihmës së shpejtë 1 (një) copë;
- i) Instrument për matjen e thellësisë së luleve të gomave 1 (një) copë;
- j) Vegla për heqjen dhe vendosjen e gomave 1 (një) seri, etj.;
- k) Kazan për mbeturinat 1 (një) copë;

AMBIENTE

- a) Ambient të mbyllur, me ndriçimin e duhur dhe instalimet e nevojshme, elektrike dhe të ajrimit, me sipërfaqe jo me pak se 30 (tridhjetë) metra katror, ku mund të qëndrojë një autoveturë ose një kamion / autobus;
 - b) Vend qëndrimi për mjetet që do të riparohen, ku mund të qëndrojë një autoveturë ose sipas rastit një kamion / autobus;
 - c) Zyrë për punë administrative;
 - d) Nyje hidrosanitare.
2. Subjektet juridike, që të pajisen me licencë për ushtrimin e veprimtarisë së riparimit dhe të mirëmbajtjes së gomave, të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove, kodi VII.3.B.1/ç, duhet të plotësojnë kushtet dhe procedurat si më poshtë vijon:
 - a) Kërkesë, nga drejtuesi ligjor, për pajisjen me licencë veprimtarie për riparimin dhe mirëmbajtjen e gomave, të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove, ku të përcaktohen, emri i subjektit, i drejtuesit ligjor dhe

përgjegjësit teknik, përmban dhe vetdeklarimin sipas formatit të hartuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit për:

- gjëndjen e tij në lidhje me organet e prokurorisë dhe të gjykatës;
 - njohjen dhe zbatimin e legjislacionin dhe të rregullave në fuqi;
 - dërgim informacioni periodik, për veprimtarinë e shoqërisë, etj;
 - informacion në lidhje me pajisjet, instrumentat dhe ambientet e nevojshme që subjekti disponon, në lidhje me fushën e veprimtarisë ku kërkohet të liçensohet;
- b) Kopje të Dëshmis së aftësisë profesionale të përgjegjësit teknik;
- c) Kontratë midis drejtuesit ligjor dhe përgjegjësit teknik, e hartuar përpara noterit, me afat të përcaktuar mbi 1 (një) vit;
- d) Dokumente pronësie dhe/ose përdorimi, që pasqyrojnë mjediset, pajisjet, instrumentat, etj;
- e) Rregullore e brendshme e funksionimit të veprimtarisë, e cila duhet të përmbajë dhe:
- Zbatimin e ligjit nr 9573, datë 03.07.2006 “Për autoriparimin, shitblerjen, depozitimin e mjeteve rrugore me motor, të rimorkiove dhe pjesëve të tyre të dala jashtë përdorimit ose të braktisura dhe për veprimtaritë që lidhen me to”;
 - Zbatimin e Udhëzimit “Autoriparimi i mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove”, i ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës;
 - Plotësimin e Regjistrimit për autoriparimin e mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove, VII.3.B.1/ç - Riparimi dhe mirëmbajtja e gomave, të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove;
 - Zbatimin e rregullave të sigurimit teknik në punë;
 - Zbatimin e rregullave të mbrojtjes nga zjarri;
- f) Dokument që vërteton ngurtësimin e vleftës së garancisë financiare.

Neni 6

VII.3.B.1/d Blerja, shitja e mjeteve me motor dhe rimorkio

1. Subjektet juridike, që të ushtrojnë veprimtarinë e blerjes dhe shitjes, të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove, duhet të disponojnë:

PAJISJE

- a) Kompjutera 2 (dy) copë;
- b) Pajisje të mbrojtjes nga zjarri 2 (dy) copë;
- c) Kutitë ndihmës së shpejtë 1 (një) copë;

d) Kazan për mbeturinat 1 (një) copë;

AMBIENTE

- a) Ambient të mbyllur, me ndriçimin e duhur për ekspozimin e mjeteve motorike ose rimorkiove, me sipërfaqe jo me pak se 50 (pesëdhjetë) metra katror, ku mund të qëndrojnë 3 (tre) autovetura ose sipas rastit 2 (dy) kamion / autobus;
 - b) Zyrë për punë administrative;
 - c) Nyje hidrosanitare.
2. Subjektet juridike, që të pajisen me licencë për ushtrimin e veprimtarisë së blerjes dhe shitjes, të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove, kodit VII.3.B.1/d, duhet të plotësojnë kushtet dhe procedurat si më poshtë vijon:
- a) Kërkesë, nga drejtuesi ligjor, për pajisjen me Licencë veprimtarie për blerjen dhe shitjen, e mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove, ku të përcaktohen emri i subjektit, i drejtuesit ligjor dhe i përgjegjësit teknik, përmban dhe vetdeklarimin sipas formatit të hartuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit për:
 - gjëndjen e tij në lidhje me organet e prokurorisë dhe të gjykatës;
 - njohjen dhe zbatimin e legjislacionin dhe të rregullave në fuqi;
 - dërgim informacioni periodik, për veprimtarinë e shoqërisë, etj;
 - informacion në lidhje me pajisjet dhe ambientet e nevojshme që subjekti disponon, në lidhje me fushën e veprimtarisë ku kërkohet të liçensohet;
 - b) Kopje të Dëshmisë së aftësisë profesionale të përgjegjësit teknik;
 - c) Kontratë midis drejtuesit ligjor dhe përgjegjësit teknik, e hartuar përpara noterit, me afat të përcaktuar mbi 1 (një) vit;
 - d) Dokumente pronësie dhe/ose përdorimi, që pasqyrojnë mjediset, pajisjet, instrumentat, etj;
 - e) Rregullore e brendshme e funksionimit të veprimtarisë, të përmbajë dhe:
 - Zbatimin e ligjit nr 9573, datë 03.07.2006 “Për autoriparimin, shitblerjen, depozitimin e mjeteve rrugore me motor, të rimorkiove dhe pjesëve të tyre të dala jashtë përdorimit ose të braktisura dhe për veprimtaritë që lidhen me to”;
 - Zbatimin e Udhëzimit “Autoriparimi i mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove”, i ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës;
 - Plotësimin e Regjistrimit për autoriparimin e mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove, VII.3.B.1/d – Blerja, shitja e mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove;

- Zbatimin e rregullave të sigurimit teknik në punë;
 - Zbatimin e rregullave të mbrojtjes nga zjarri;
- f) Dokument që vërteton ngurtësimin e vleftës së garancisë financiare.

Neni 7

VII.3.B.1/dh Mbledhja, depozitimi, shkatërrimi i mjeteve ose pjesëve të tyre të dala jashtë përdorimit apo të braktisura

1. Subjektet juridike, që të ushtrojnë veprimtarinë e mbledhjes, depozitimit, shkatërrimit, të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove, ose të pjesëve të tyre, të dala jashtë përdorimit apo të braktisura, duhet të disponojnë:

PAJISJE DHE INSTRUMENTA

- a) Pajisje për presimin e pjesëve të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove, të dala jashtë përdorimit 1 (një) copë;
- b) Kompjuteri 2 (dy) copë;
- c) Pajisje të mbrojtjes nga zjarri 2 (dy) copë;
- d) Kutitë ndihmës së shpejtë 1 (një) copë;
- e) Vegla dhe çelsa të ndryshme, për zmontime mjetesh, 2 (dy) seri, etj.;
- f) Kazan për mbeturinat 2 (dy) copë;
- g) Fuçi 1 (një) copë apo bidona 10 litra 5 (pesë) copë, për grumbullimin e vajrave të përdorur.

AMBIENTE

- a) Sipërfaqe për: depozitimin e mjeteve që do të shkatërrohen, me sipërfaqe jo më pak se 100 (njëqind) metra katror ku mund të qëndrojnë 4 (katër) autovetura ose sipas rastit 2 (dy) kamion / autobus, sipërfaqe për pjesët e ndërrimit të dala jashtë përdorimit, etj.;
 - b) Zyrë për punë administrative;
 - c) Nyje hidrosanitare.
2. Subjektet juridike, që të pajisen me licencë për ushtrimin e veprimtarisë së mbledhjes, depozitimit, shkatërrimit, të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove, ose pjesëve të tyre të dala jashtë përdorimit apo të braktisura, kodi VII.3.B.1/dh, duhet të plotësojnë kushtet dhe procedurat si më poshtë:
 - a) Kërkesë, nga drejtuesi ligjor, për pajisjen me Licence veprimtarie për mbledhjen, depozitimin, shkatërrimin, të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove, ose të pjesëve të tyre të dala jashtë përdorimit apo të braktisura, ku të përcaktohen, emri i subjektit, i drejtuesit ligjor dhe i përgjegjësit teknik, përmban dhe vetdeklarimin sipas formatit të hartuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit për:
 - gjëndjen e tij në lidhje me organet e prokurorisë dhe të gjykatës;

- njohjen dhe zbatimin e legjislacionin dhe të rregullave në fuqi;
 - dërgim informacioni periodik, për veprimtarinë e shoqërisë, etj;
 - informacion në lidhje me pajisjet, instrumentat dhe ambientet e nevojshme që subjekti disponon, në lidhje me fushën e veprimtarisë ku kërkohet të liçensohet;
- b) Kopje të Dëshmis së aftësisë profesionale të përgjegjësit teknik;
- c) Kontratë midis drejtuesit ligjor dhe përgjegjësit teknik, e hartuar përpara noterit, me afat të përcaktuar mbi 1 (një) vit;
- d) Dokumente pronësie dhe/ose përdorimi, që pasqyrojnë mjediset, pajisjet, instrumentat, etj;
- e) Rregullore e brendshme e funksionimit të veprimtarisë, e cila duhet të përmbajë:
- Zbatimin e ligjit nr 9573, datë 03.07.2006 “Për autoriparimin, shitblerjen, depozitimin e mjeteve rrugore me motor, të rimorkiove dhe pjesëve të tyre të dala jashtë përdorimit ose të braktisura dhe për veprimtaritë që lidhen me to”;
 - Zbatimin e Udhëzimit “Autoriparimi i mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove”, i ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës;
 - Plotësimin e Regjistrimit për autoriparimin e mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove, VII.3.B.1/dh – Mbledhja, depozitimi, shkatërrimi i mjeteve ose pjesëve të tyre të dala jashtë përdorimit apo të braktisura;
 - Zbatimin e rregullave të sigurimit teknik në punë;
 - Zbatimin e rregullave të mbrojtjes nga zjarri;
- f) Dokument që vërteton ngurtësimin e vleftës së garancisë financiare.

Neni 8

1. Përpara marrjes së licencës së veprimtarisë, subjektet duhet të ngurtësojnë dhe të dorëzojnë në Qendrën Kombëtare të Licencimit, vlerën e garancisë prej 100.000 (njëqind mijë) lekë, për çdo nënkategori (a, b, c, ç, d, dh) të veprimtarive të autoriparimit me kodin VII.3.B.1.

Neni 9

1. Përgjegjësi teknik, për të marrë Dëshmin e aftësisë profesionale, duhet të ketë njohuritë e domosdoshme mbi:

VII.3.B.1/a Riparimi dhe mirëmbajtja e pjesëve mekanike dhe të motorit, të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove

- a) Ligjin nr 9573, datë 03.07.2006 “Për autoriparimin, shitblerjen, depozitimin e mjeteve rrugore me motor, të rimorkiove dhe pjesëve të

tyre të dala jashtë përdorimit ose të braktisura dhe për veprimtaritë që lidhen me to”;

- b) Udhëzimin “Autoriparimi i mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove”, e ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës;
- c) Përgatitjen tekniko profesionale, për veprimtarinë e riparimit dhe të mirëmbajtjes së pjesëve mekanike dhe të motorit, të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove;
- d) Rregullat e sigurimit teknik në punë;
- e) Rregullat e mbrojtjes nga zjarri.

VII.3.B.1/b Riparimi dhe mirëmbajtja e karrocisë, të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove.

- a) Ligjin nr 9573, datë 03.07.2006 “Për autoriparimin, shitblerjen, depozitimimin e mjeteve rrugore me motor, të rimorkiove dhe pjesëve të tyre të dala jashtë përdorimit ose të braktisura dhe për veprimtaritë që lidhen me to”;
- b) Udhëzimin “Autoriparimi i mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove”, e ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës;
- c) Përgatitjen tekniko profesionale, për veprimtarinë e riparimit dhe të mirëmbajtjes së karrocise, të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove;
- d) Rregullat e sigurimit teknik në punë;
- e) Rregullat e mbrojtjes nga zjarri.

VII.3.B.1/c Riparimi dhe mirëmbajtja e impiantit elektrik, të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove

- a) Ligjin nr 9573, datë 03.07.2006 “Për autoriparimin, shitblerjen, depozitimimin e mjeteve rrugore me motor, të rimorkiove dhe pjesëve të tyre të dala jashtë përdorimit ose të braktisura dhe për veprimtaritë që lidhen me to”;
- b) Udhëzimin “Autoriparimi i mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove”, e ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës;
- c) Përgatitjen tekniko profesionale, për veprimtarinë e riparimit dhe të mirëmbajtjes së pjesëve elektrike, të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove;
- d) Rregullat e sigurimit teknik në punë;
- e) Rregullat e mbrojtjes nga zjarri.

VII.3.B.1/ç Riparimi dhe mirëmbajtja e gomave, të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove

- a) Ligjin nr 9573, datë 03.07.2006 “Për autoriparimin, shitblerjen, depozitimin e mjeteve rrugore me motor, të rimorkiove dhe pjesëve të tyre të dala jashtë përdorimit ose të braktisura dhe për veprimtaritë që lidhen me to”;
- b) Udhëzimin “Autoriparimi i mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove”, e ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës;
- c) Përgatitjen tekniko profesionale, për veprimtarinë e riparimit dhe të mirëmbajtjes së gomave, të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove;
- d) Rregullat e sigurimit teknik në punë;
- e) Rregullat e mbrojtjes nga zjarri;

VII.3.B.1/d Blerja, shitja e mjeteve me motor dhe rimorkio

- a) Ligjin nr 9573, datë 03.07.2006 “Për autoriparimin, shitblerjen, depozitimin e mjeteve rrugore me motor, të rimorkiove dhe pjesëve të tyre të dala jashtë përdorimit ose të braktisura dhe për veprimtaritë që lidhen me to”;
- b) Udhëzimin “Autoriparimi i mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove”, e ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës;
- c) Përgatitjen tekniko profesionale, për veprimtarinë e blerjes dhe shitjes, të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove, dhe të pjesëve të ndërrimit të tyre;
- d) Rregullat e sigurimit teknik në punë;
- e) Rregullat e mbrojtjes nga zjarri;

VII.3.B.1/dh Mbledhja, depozitimi, shkatërrimi i mjeteve ose pjesëve të tyre të dala jashtë përdorimit apo të braktisura

- a) Ligjin nr 9573, datë 03.07.2006 “Për autoriparimin, shitblerjen, depozitimin e mjeteve rrugore me motor, të rimorkiove dhe pjesëve të tyre të dala jashtë përdorimit ose të braktisura dhe për veprimtaritë që lidhen me to”;
- b) Ligjin nr. 8378, datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, neni 102;
- c) Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 153, datë 07.04.2000 “Rregullorja e zbatimit të Kodit Rrugor në Republikën e Shqipërisë”, neni 252;
- d) Udhëzimin “Autoriparimi i mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove”, e ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës;
- e) Përgatitjen tekniko profesionale, për veprimtarinë e mbledhjes, depozitimit, shkatërrimit, të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove, ose të pjesëve të tyre të dala jashtë përdorimit apo të braktisura;

- f) Rregullat e sigurimit teknik në punë;
- g) Rregullat e mbrojtjes nga zjarri.

Neni 10

1. Modelet e regjistrave për çdo veprimtari autoriparimi, me kodin VII.3.B.1/a, b, c, ç, d, dh, janë bashkëlidhur këtij udhëzimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.
2. Plotësimi i regjistrave, duhet të bëhet i plotë, me saktësi dhe në mënyrë të rregullt kronologjike.
3. Çdo ndërhyrje në riparimin e mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove, do të shoqërohet me garanci.
4. Ruajtja e regjistrave në arshivë, duhet të bëhet sipas rregullave të arshivave.

Neni 11

1. Drejtorja e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor organizon kurse kualifikimi për ngritjen e nivelit tekniko-profesional të përgjegjësve teknikë dhe të punonjësve të tjerë të subjekteve, që ushtrojnë veprimtari autoriparimi, me kodin VII.3.B.1/a, b, c, ç, d, dh, sipas programeve të përgatitura prej saj, bazuar dhe në njohuritë e domosdoshme të përcaktuara në këtë udhëzim.
2. Përgjegjësi teknik, për t'u pajisur me "Dëshmi aftësie profesionale", duhet të paraqesë në Drejtorin Rajonale të Shërbimeve të Transportit Rrugor:
 - a) Kërkesë për pajisje me "Dëshmi aftësie profesionale", ku të përcaktohen, nënkategoria ku do të aplikojë dhe veprimtaria e tij e kryer, nga marrja e diplomës në formën e CV;
 - b) Kopje të noterizuar të diplomës;
 - c) Kopje të kartës së identitetit;
 - d) Dokumentacion teknik justifikues (origjinal ose kopje të noterizuar) për çka është përshkruar si veprimtari e kryer në CV; vërtetime nga subjekte, institucione apo organizma, çertifikata kursi apo specializimi, që kanë lidhje me fushën e veprimtarisë së seksionit përkatës, etj;
 - e) Vetdeklarim i personit, në lidhje me gjëndjen e tij me organin e gjykatës, që nuk është dënuar me vendim të formës së prerë për vepra penale të kryera në ushtrimin e veprimtarive të përmendura në pikën 2, të nenit 3, të ligjit 9573, datë 03.07.2006;
3. Përgjegjësi teknik pajiset me "Dëshmi aftësie profesionale" nga Drejtorja e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, pasi komisioni të ketë dhënë rezultat pozitiv për provimin, mbi nivelin e njohurive të përgjegjësve teknik, sipas nënkategorive ku kërkon aplikanti, të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni.

4. Pyetjet dhe tezat e provimit përgatiten dhe miratohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor.
5. Përbërja e komisionit të provimit të nivelit të njohurive të përgjegjësve teknik për pajisje me "Dëshmi aftësie profesionale" përcaktohet nga ministri përgjegjës për transportin. Komisioni duhet të përbëhet nga punonjës të ministrisë përgjegjëse për transportin dhe të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor.

Neni 12

1. Udhëzimi nr. 8, datë 03.07.2007 "Për ushtrimin e veprimtarisë së autoriparimit sipas seksioneve", shfuqizohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në "Fletoren zyrtare".

MINISTËR

Edmond Haxhinasto

MODELI I REGJISTRIT PËR AUTORIPARIMIN E MJETEVE RRUGORE ME MOTOR DHE RIMORKIOVE

VII.3.B.1/a Riparimi dhe mirëmbajtja e pjesëve mekanike dhe të motorit, të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove

Nr.	Data e hyrjes	Gjeneralitet e personit dorëzues të autorizuar			Tipi i mjetit	Numri i targës	Numri i shasisë	Të dhëna për ndërhyrjen e kryer	Gjeneralitet e personit marrës të autorizuar			Garancia punimeve	Data e dorëzimit
		Emri Mbiemri	Nr. identifikimit	Firma					Emri Mbiemri	Nr. identifikimit	Firma		

Shënim: Regjistri duhet të plotësohet në mënyrë të saktë, kronologjikisht dhe pa gabime.

MODELI I REGJISTRIT PËR AUTORIPARIMIN E MJETEVE RRUGORE DHE RIMORKIOVE

VII.3.B.1/b Riparimi dhe mirëmbajtja e karocersë, të mjeteve rrugore dhe rimorkiove

Nr.	Data e hyrjes	Gjeneralitet e personit dorëzues të autorizuar			Tipi i mjetit	Numri i targës	Numri i shasisë	Të dhëna për ndërhyrjen e kryer	Gjeneralitet e personit marrës të autorizuar			Garancia punimeve	Data e dorëzimit
		Emri Mbiemri	Nr. identifikimit	Firma					Emri Mbiemri	Nr. identifikimit	Firma		

Shënim: Regjistri duhet të plotësohet në mënyrë të saktë, kronologjikisht dhe pa gabime.

MODELI I REGJISTRIT PËR AUTORIPARIMIN E MJETEVE RRUGORE DHE RIMORKIOVE

VII.3.B.1/c Riparimi dhe mirëmbajtja e impiantit elektrik, të mjeteve rrugore dhe rimorkiove

Nr.	Data e hyrjes	Gjeneralitet e personit dorëzues të autorizuar			Tipi i mjetit	Numri i targës	Numri i shasisë	Të dhëna për ndërhyrjen e kryer	Gjeneralitet e personit marrës të autorizuar			Garancia punimeve	Data e dorëzimit
		Emri Mbiemri	Nr. identifikimit	Firma					Emri Mbiemri	Nr. identifikimit	Firma		

Shënim: Regjistri duhet të plotësohet në mënyrë të saktë, kronologjikisht dhe pa gabime.

MODELI I REGJISTRIT PËR AUTORIPARIMIN E MJETEVE RRUGORE DHEE RIMORKIOVE

VII.3.B.1/ç Riparimi dhe mirëmbajtja e gomave, të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove

Nr.	Data e hyrjes	Gjeneralitet e personit dorëzues të autorizuar			Tipi i mjetit	Numri i targës	Numri i shasisë	Të dhëna për ndërhyrjen e kryer	Gjeneralitet e personit marrës të autorizuar			Garancia punimeve	Data e dorëzimit
		Emri Mbiemri	Nr. identifikimit	Firma					Emri Mbiemri	Nr. identifikimit	Firma		

Shënim: Regjistri duhet të plotësohet në mënyrë të saktë, kronologjikisht dhe pa gabime.

MODELI I REGJISTRIT PËR AUTORIPARIMIN E MJETEVE RRUGORE DHE RIMORKIOVE

VII.3.B.1/d Blerja, shitja e mjeteve rrugore me motor dhe rimorkio

Nr.	Data e hyrjes	Gjeneralitet e personit dorëzues të autorizuar			Tipi i mjetit	Numri i targës	Numri i shasisë	Të dhëna për ndërhyrjen e kryer	Gjeneralitet e personit marrës të autorizuar			Garancia punimeve	Data e dorëzimit
		Emri Mbiemri	Nr. identifikimi	Firma					Emri Mbiemri	Nr. identifikimi	Firma		

Shënim: Regjistri duhet të plotësohet në mënyrë të saktë, kronologjikisht dhe pa gabime.
 Të dhënat për origjinën e mjeteve dhe/ose rimorkiove shënohen në çastin e marrjes në ngarkim.
 Të dhënat për shitjen ose heqjen shënohen në çastin e shitjes ose heqjes së tyre.

MODELI I REGJISTRIT PËR AUTORIPARIMIN E MJETEVE RRUGORE DHE RIMORKIOVE

VII.3.B.1/dh Mbledhja, depozitimi, shkatërrimi i mjeteve ose pjesëve të tyre të dala jashtë përdorimit apo të braktisura

Nr.	Data e hyrjes	Gjeneralitet e personit dorëzues te autorizuar			Tipi i mjetit	Numri i targës	Numri i shasisë	Te dhëna për elementet e ri-shfrytëzueshme	Elementet e ri-shfrytëzueshëm të shitur	Elementet e papërdorura për riciklim	Metoda e trajtimit	Gjeneralitet e personit marrës të autorizuar			Data e dorëzimit
		Emri Mbiemri	Nr. identifikimi	Firma								Emri Mbiemri	Nr. identifikimi	Firma	

Shënim: Regjistri duhet të plotësohet në mënyrë të saktë, kronologjikisht dhe pa gabime.